SUBJEKTI “BAITEL - BOJO RESORT” SH.P.K

VLORE me 21/01/2026

# DREJTUAR: AKM-TIRANE

# PER DIJENI: DRM- FIER VLORE GJIROKASTER

## LENDA: KERKESE PER PJESEMARRJE NE ORGANIZIMIN E KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE PALET E INTERESUARA PER APLIKIMIN PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B:

**“TRAJTIMI I UJËRAVE DHE UJËRAVE TË ZEZA”**
**ID 6.1. INSTALIM TRAJTIMI PËR UJËRAT E NDOTURA URBANE - KAPACITETI KUFI PER LEJET E TIPIT B: TË GJITHA INSTALIMET.**

**SUBJEKTI: “BAITEL - BOJO RESORT” SH.P.K**

**ADMINISTRATORI: Z. BOJO BEGOTARAJ**

**VENDNDODHJA: VLORE ORIKUM ORIKUM RADHIME.**

**VLORE**

# SUBJEKTI “BAITEL - BOJO RESORT” SH.P.K

SUBJEKTI “BAITEL - BOJO RESORT” ME PERFAQESUES LIGJOR Z. BOJO BEGOTARAJ MERRET ME AKTIVITETIN:

**“TRAJTIMI I UJËRAVE DHE UJËRAVE TË ZEZA”**

**ID 6.1. INSTALIM TRAJTIMI PËR UJËRAT E NDOTURA URBANE - KAPACITETI KUFI PER LEJET E TIPIT B: TË GJITHA INSTALIMET.**

SUBJEKTI : “BAITEL - BOJO RESORT” ME NR. NIPTI: K26813201S

ADMINISTRATORI: Z. BOJO BEGOTARAJ

VENDNDODHJA: VLORE ORIKUM ORIKUM RADHIME..

TRUALLI NE TE CILEN NDODHET OBJEKTI, SHTRIHET NE NJE TERREN TE RRAFSHET NDERSA PRONA ESHTE E KARAKTERIZUAR NGA NJE SIPERFAQE UNIFORME KU EFEKTI I EROZIONIT NUK ESHTE I NDJESHEM.

**RELACION TEKNIK**

**Sistem i grumbullimit, trajtimit dhe pompimit të ujërave të ndotura për kuzhinë profesionale – 1000 vakte/ditë**

**Objekti: Restorant BOJO**
**Vendodhja: Radhime**

**1. Qëllimi i relacionit**

Ky relacion teknik është hartuar për të dokumentuar, justifikuar dhe verifikuar zgjidhjen teknike të zgjedhur për **menaxhimin e ujërave të ndotura me përmbajtje yndyrnash dhe ujërave fekale**, që burojnë nga një **strukturë gastronomike profesionale** me kapacitet **1000 vakte në ditë**, e zhvilluar në një godinë **3-katëshe me podrum**, në përputhje të plotë me **standardet europiane në fuqi**.

Relacioni shërben për:

- kontroll teknik dhe ligjor,
- verifikim përputhshmërie me normat DIN/EN,
- dokumentim për kolaudim dhe pranim përfundimtar të sistemit.

---

**2. Përshkrimi i objektit dhe organizimi funksional**

Godina përbëhet nga këto nivele funksionale:

**2.1 Kati -1 (Podrum)**

Në këtë nivel janë të pozicionuara:

- Kuzhina kryesore profesionale
- Ambientet e magazinimit
- Ambienti teknik
- Tualetet e stafit
- Ambienti i përpunimit të peshkut

Të gjitha këto ambiente gjenerojnë ujëra të ndotura me përmbajtje:

- yndyrnash,

- mbetjesh ushqimore,
- ujëra sanitare fekale.

**2.2 Kati 0**

- Banaku i kafesë
- Kuzhinë e vogël e hapur
- Ambient restoranti
- Tavolina të jashtme

Kuzhina e katit 0 shkarkon **në të njëjtin sistem ndarës yndyrnash**, sipas kërkesave të DIN EN 1825.

**2.3 Kati 1**

- Ambient restoranti
  Shkarkimet e këtij kati janë të menaxhuara nëpërmjet sistemit të përgjithshëm të godinës.

---

### 3. Analiza e ngarkesës hidraulike të kuzhinës

Llogaritja e kapacitetit është kryer sipas **DIN EN 1825-2 & DIN 4040-100**, duke marrë në konsideratë:

- Tipin e aktivitetit: **kuzhinë komerciale – restorant specialitetesh**
- Kapaciteti ditor: **1000 vakte**
- Orë pune ditore: **13 orë**
- Pajisjet aktive të kuzhinës:
  - kazanë zierjeje,
  - lavapjata industriale,
  - lavamani me dhe pa sifon,
  - makina larëse,
  - furra konvektive,
  - pajisje për përpunim perimesh dhe peshku.

Sipas dokumentit të llogaritjes:

- Prurja e matur e ujërave të ndotura: **Qs = 13.0 l/s**
- Faktor rëndues fr = **1.3**
- Madhësia nominale e llogaritur:
  **NS = 16.9**
- Madhësia nominale e sistemit të zgjedhur:
  **NS 20**

Kjo përzgjedhje garanton **rezervë sigurie operative** dhe përputhje të plotë me normativat

8dd442bb-871a-7647-ad45-c59d179...

.

---

### 4. Sistemi i ndarjes së yndyrnave

**4.1 Konfigurimi i sistemit**

Për të përballuar kërkesën **NS 20**, janë instaluar:

- **2 x Grease Separator EasyClean free NS 10**
- Konfigurim paralel (NS10 + NS10 = NS20)
- Tip: **Auto Mix**
- Kodi produkti: **93010.01/DSP**

Kjo zgjidhje:

- siguron ndarje efikase të yndyrnave,
- lejon mirëmbajtje të lehtë,
- ofron fleksibilitet operacional dhe siguri në rast ngarkesash të pabarabarta.

**4.2 Pajisje monitorimi dhe kontrolli**

Çdo ndarës është i pajisur me:

- **SonicControl – Layer thickness measuring device (917821)**
  për matjen e trashësisë së shtresës së yndyrës,
- **Sampling system DN100/150, dalje vertikale**, për marrje mostrash sipas kërkesave ligjore.

**4.3 Ventilim dhe shkarkim yndyrnash**

Secili ndarës është i pajisur me:

- tubacion **DN75**, i lidhur deri në rrethimin e godinës,
- funksion për largimin e sigurt të gazrave dhe aromave,
- parandalim të mbipresionit dhe grumbullimit të gazrave.

---

### 5. Sistemi i pompimit të ujërave nga ndarësi i yndyrnave

**5.1 Stacioni i pompimit**

Për largimin e ujërave të përpunuara nga ndarësi është instaluar:

- **Lifting station Aqualift XL 300 l Duo**
- Pompa: **SPF 3000-S3**
- Valvul mbyllëse: **shut-off valve**
- Kodi: **11048**

**5.2 Parametrat hidraulikë**

Sipas llogaritjeve:

- Kapacitet pompimi Qp = **39.31 $m^3/h$**
- Lartësi pompimi Hp = **4.30 m**
- Diametri i linjës së shtytjes: **DN100**
- Gjatësia e linjës: **12 m**
- Shpejtësia e rrjedhës: **1.48 m/s**

Këto vlera janë brenda kufijve optimalë të **EN 12056**, duke garantuar funksionim të qëndrueshëm dhe jetëgjatësi të sistemit .

---

### 6. Sistemi i pompimit të ujërave fekale të tualeteve të podrumit

Në podrum janë instaluar:

- **2 stacione pompimi identike Aqualift XL 300 l Duo**
- Një për ujërat nga kuzhina
- Një për ujërat fekale të tualeteve

Të dy stacionet janë:

- të lidhura me **bypass emergjence**,
- funksionojnë në regjim **redundance**,
  duke garantuar vazhdimësi shërbimi edhe në rast defekti.

---

### 7. Përputhshmëria me standardet

Sistemi është projektuar dhe dimensionuar në përputhje të plotë me:

- **DIN EN 1825-2**

- **DIN 4040-100**
- **EN 12056-2 / 3 / 4**

Të gjitha komponentët janë:

- të certifikuar CE,
- të përshtatshëm për instalim brenda godinave,
- të zgjedhur për përdorim intensiv profesional.

---

### 8. Përfundim teknik

Bazuar në:

- analizën hidraulike,
- kapacitetin real të kuzhinës,
- konfigurimin e godinës,
- dokumentacionin zyrtar të prodhuesit,

**sistemi i ndarjes dhe pompimit të ujërave të ndotura i projektuar është teknikisht i saktë, i sigurt dhe plotësisht i përputhshëm me standardet europiane**, duke garantuar funksionim normal, mirëmbajtje të kontrolluar dhe mbrojtje të rrjetit publik të kanalizimeve.

# SUBJEKTI “BAITEL - BOJO RESORT” SH.P.K

## EKSTRAKT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | K26813201S |
| 2. Data e Regjistrimit | 13/06/2002 |
| 3. Emri i Subjektit | BAITEL - BOJO RESORT SHPK |
| 4. Forma ligjore | SHPK |
| 5. Data e themelimit | 13/06/2002 |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 13/06/2002 |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Vlore Orikum ORIKUM Rruga Nacionale Vlore-Orikum, Kilometri 16, Godine 1-kateshe, zona kadastrale nr.3140 |
| 8. Kapitali | 2.429.230,00 |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 100,00 |
| 9. Objekti i aktivitetit | Import-eksport, Bar-Restorant, Stacion plazhi, Pastrim i siperfaqeve urbane, Shitje Blerje e dhenie me qera.Punime germim ne toke, ndertime civile dhe industrial, rikonstruksione dhe mirembajtje godinash civile dhe industrial veshje fasada, rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramway, metro, pista aeroportuale, punime nentokesore, ura e vepra arti, diga e tunele hidroteknike, ujesjellesa, gazesjellsa, vajsjellsa, vepra kullimi e vaditje, ndertime detare dhe punime thellimi ne uje, punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime, ndertimi i impianteve per prodhimin e energjise elektrike, ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatoreve,linjat e TN e te mesem dhe shpendarjen e energjise.Punime speciale ndertimi Punime per prishjen e ndertimeve,impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtje e tyre, impiante ngritese dhe transportuse (ashensore, shkalle levizese, transportues), punime rifiniture me material druri, plastike, metalike dhe xhami, rifiniture te natyres teknike ndertuse, impinte te sinjalistikes ndricuse te trafikut, sinjalistika rrugore jo ndricuse, barriera dhe mbrojtje rrugore ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri, punime strukturore special, shtresa dhe mbi struktura specal, punime mbi shina dhe tranversa, impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit, impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni, impinte te brendshme |

Kopje nga web

| | | |
|---|---|---|
| | elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj. Punime topogjeodezike, shqipme gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje.Grumbullimin, transportimin dhe menaxhimin e mbetjeve. Turiozem detare e bregdetar, akomodim, peshkim, ruatje e peshkut dhe produkteve te tjera te detit, shetitje dhe ture me varka, kurse noti, lojra uji.Sherbime kateringu | |
| 10. Administratori/ët | Bojo Begotaraj | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 07/03/2022 | Deri: 07/03/2027 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka) | A & E AUDITING | |
| 12.1 Afati i emërimit | Nga: | Deri: |
| 13. Ortakët | BojoBegotaraj | |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 2.429.230,00 | Natyre: |
| 13.2 Numri i pjesëve | 100,00 | |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Vlore Vlore Makine Lloji Autoveture, Marka Mercedes Benz Sprinter 213 CDI, Targa AB 579 DI Vlore Orikum ORIKUM RADHIME Vlore Vlore VLORE Makine lloji ATP, Marka Wolksvagen Caddy targa AA 451 YF | |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: BAITEL - BOJO RESORT SHPK<br>E-Mail: bojobegoteraj@gmail.com<br>Telefon: 0692079023<br>Të Tjera: - | |
| 16. Statusi: | Aktiv | |

Kopje nga web

Datë: 21/01/2026

____________________
Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

# SUBJEKTI "BAITEL - BOJO RESORT" SH.P.K

## LOCATION I SUBJEKTIT NGA GOOGLE MAPS




## LOCATION I SUBJEKTIT NGA ASIG



# SUBJEKTI “BAITEL - BOJO RESORT” SH.P.K

## FOTO TE AKTIVITETIT






# SUBJEKTI “BAITEL - BOJO RESORT” SH.P.K



TEKNOLOGJIA ESHTE E THJESHTE DHE TRADICIONALE POR GJITHSESI DUKE PERDORUR MAKINERI TE KOHES DHE CILESORE.
MBETJET RICIKLOHEN OSE GRUMBULLOHEN NE NJE PIKE TE CAKTUAR DHE DERGOHEN NE VENDIN E CAKTUAR NGA BASHKIA.
TERRITORI DHE AMBIENTI BRENDA DHE JASHTE ESHTE GJITHMONE I PASTER, I SISTEMUAR DUKE MBJELLE BIME DEKORATIVE. MIREMBAHET ME KUJDES RRJETI I BRENDSHEM I FURNIZIMIT ME UJE DHE ENERGJI ELEKTRIKE SI DHE SISTEMI KULLUES I UJERAVE. RESPEKTOHEN RIGOROZISHT RREGULLAT HIGJIENO SANITARE DHE TE SIGURIMIT TEKNIK TE PUNONJESVE TE SUBJEKTIT DHE TE MOS USHTROHET ASNJE NDIKIM NEGATIV NE SHENDETIN E POPULLATES.

DUHET THEKSUAR QE SUBJEKTI KA KOHE QE E USHTRON KETE AKTIVITET NE KETO AMBIENTE DHE NUK KA PATUR PROBLEME ME KOMUNITETIN DHE SIPERMARRESIT E ZONES.
TRUALLI NE TE CILEN NDODHET OBJEKTI, SHTRIHET NE NJE TERREN TE RRAFSHET NDERSA PRONA ESHTE E KARAKTERIZUAR NGA NJE SIPERFAQE UNIFORME KU EFEKTI I EROZIONIT NUK
TERITORI I ZGJEDHUR ESHTE I PERSHTATSHEM PER FUNKSIONIMIN E KETIJ AKTIVITETI DUKE PARAQITUR DISA PERPARESI SI:

- SISTEM PERSPEKTIV TE FURNIZIMIT ME UJE
- SISTEM PERSPEKTIV TE FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE.

- MUNDESI PER ZBATIMIN KOREKT TE PROJEKTIT
- MUNDESI PER NGRITJE TE SISTEMIT TE KANALIZIMEVE DHE SHKARKIMEVE.

POZICIONI I SHESHIT KA TE ZGJIDHURA DISA NGA PROBLEMET QE LIDHEN ME ANEN FUNKSIONALE SI:

- LARGESI TE MJAFTUSHME NGA VENDET E BANUARA.
- PRANE FUQISE PUNETORE.

AKTIVITETI ZHVILLOHET KA KOHË QË EKZISTON DHE NUK KA PATUR ASNJE PROBLEM ME KOMUNITETIN DHE NUK KA SHKAKTUAR PROBLEME TË NDOTJES SË MJEDISIT.

ME KËTË RAPORT SIGUROJMË ORGANET PËRKATËSE SHTETËRORE, VENDIM – MARRËSE, SE PROJEKTI I ZBATIMIT DHE TEKNOLOGJIA E PROJEKTUAR ËSHTË BASHKËKOHORE, CILËSORE DHE PLOTËSON STANDARTET E VENDOSURA NGA BASHKIMI EVROPIAN.

**BAZA LIGJORE**

- LIGJI NR 10 431, DATE 9.6.2011 “PER MBROJTJEN E MJEDISIT”
- LIGJI NR 10 440,DATE. 7.7.2011 “PER VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS” DHE NDRYSHIMET E TIJ.
- LIGJI NR. 10 448, DATE 14.07.2011 “PER LEJET E MJEDISIT
- LIGJI NR. 9115,DATE. 24.07.2003 “PER TRAJTIMIN MJEDISOR TE UJERAVE TE NDOTUR”
- LIGJI NR. 9537,DATE. 18.05.2006 “PER ADMINISTRIMIN E MBETJEVE TE RREZIKSHME”
- LIGJI 9587 DATE 20.07.2006 “PER MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT”
- LIGJI NR. 10463, DATE 22.09.2011 “ PER MENAXHIMIN E INTEGRUAR TE MBETJEVE”
- V.K.M NR. 1189 DATE 18.11.2009 “PER RREGULLAT DHE PROCEDURAT PER HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMIT KOMBETAR TE MONITORIMIT TE MJEDISIT”
- VKM NR. 402, DATË 30.6.2021 “PER MIRATIMIN E KATALOGUT SHQIPTAR TE KLASIFIKIMIT TE MBETJEVE”
- VKM NR.435,DATE.12.09.2002“PER NORMAT E SHKARKIMEVE NE AJER NE

REPUBLIKEN E SHQIPERISE”

- VKM NR.103, DATE. 31.03.2003 “PER MONITORIMIN E MJEDISIT NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”
- VKM 435, DATE 12/09/2002 "PER MIRATIMIN E NORMAVE TE SHKARKIMIT NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE".
- Udhezimi Nr.2, date 15.11.2023 “Per Nivelin Kufi te zhurmes per nje mjedis te dhene dhe per fushen e veprimtarive ekonomike-shoqerore”
- VKM 177, DATE 31/03/2005 "PER NORMAT E LEJUARA TE SHKARKIMEVE TE LENGETA DHE KRITERET E ZONIMIT TE MJEDISEVE UJORE PRITESE".
- LIGJI NR. 10 433, DATE 16.06.2011 “ PER INSPEKTIMIN NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”
- LIGJI NR. 10279 , DATE 20.05.2010 “PER KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE”
- LIGJI NR. 9824, DATE 1.11.2007 “PER AKREDITIMIN E ORGANIZMAVE TE VLERSIMIT TE KONFORMITETIT NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”

**NDIKIMET NË MJEDIS**

KY AKTIVITET NUK PRITET TË KETË NDIKIM MJEDISOR TË MATSHËM PASI:

- USHTRIMI I KËTIJ AKTIVITETI NUK DO TË NDIKOJE NË NDRYSHIMIN E NIVELIT TË UJRAVE TOKËSORE, NË RRUGËT UJORE DHE NË NIVELIN HIDROSTATIK TË UJRAVE NËNTOKËSORE, PASI NË KËTË ZONË KU NDODHET OBJEKTI DHE PËRRETH TIJ NUK KA BURIME UJORE NËNTOKËSORE DHE SHPIME TË NDRYSHME HIDROGJEOLOGJIKE QË DO TË MUND TË DËMTOHESHIN NGA KY AKTIVITET.
- NUK SHKAKTON NDOTJE TË TOKËS ME SHKARKIME TË NDRYSHME TË LËNGËTA APO TË NGURTA.
- USHTRIMI I KËTIJ AKTIVITETI NUK DO TË NDIKOJË NË CILËSINË E AJRIT TË ZONËS, PASI NUK DO TË KETË SHKARKIME NË AJËR TË GAZRAVE, PLUHURAVE APO TYMRAVE.
- GJATË USHTRIMIT TË KËTIJ AKTIVITETI NUK DO TË KETË EMETIME TË NDRYSHME KIMIKE TË LLOJEVE TË NDRYSHME.

- NUK PARASHIKOHEN DËMTIME TË FLORËS DHE FAUNËS SË ZONËS.
- ZHURMAT NË MJEDISET E PUNËS JANË BRENDA NORMËS SANITARE TË LEJUAR, DHE PËR PASOJË AS ZHURMAT NË MJEDISET E JASHTME NUK PRITET TË KENË NDIKIM NË POPULLATËN PËRRETH. NIVELI I ZHURMES NUK I KALON 55DB(A) GJATE PUNES. KY NIVEL ZHURMASH ËSHTË BRENDA NORMAVE DHE NUK NDIKON NË SHËNDETIN E PUNONJËSVE.
- KA VLERA NORMALE TË TEMPERATURËS DHE TË LAGËSHTISË NË MJEDISET E PUNËS
- JANË MARRË TË GJITHA MASAT PËR MBROJTJEN NË PUNË NGA AKSIDENTET DHE PËR EVITIMIN E RREZIKUT NGA ZJARRI.
- FENOMENE TË TJERA. VIBRACIONI, NXEHTËSIA, RADIACIONI, NDRIÇIMI VERBUES ETJ. NUK JANË TË PRANISHME.
- TRAFIKU GJATË KËTIJ AKTIVITETI NUK DO TË KETË NDIKIME NË AKTIVITETIN RRUGOR.
- PROJEKTET E TJERA SI: RRUGËT E REJA, KANALET E UJRAVE TË ZEZA, BANESAT, LINJA TË ENERGJISË, NAFTË DHE GAZSJELLËS, LINJA TË TELEKOMUNIKACIONIT ETJ.

**ZBATIMI I KUSHTEVE PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B**

- SUBJEKTI KA SIGURUAR ZBATIMIN E MASAVE QE PARANDALOJNE NDOTJEN E MJEDISIT DHE SHKARKIMET MBI NORMEN E LEJUAR PER AJRIN, PER UJIN DHE PER TOKEN, PAKESIMIN DHE RIPERDORIMIN E MBETJEVE QE GJENERON VEPRIMTARIA SI DHE RESPEKTIMIN E KERKESAVE DHE TE KUSHTEVE TE LEJES MJEDISORE.
- SUBJEKTI GJATE KRYERJES SE KETIJ AKTIVITETI LAG DHE SPERKAT MJEDISIN PERRETH NJE DERI DY HERE NE DITE PER TE REDUKTUAR ÇLIRIMET E PLUHURAVE. FURNIZIMI ME LENDE TE PARE DHE TRANSPORTI BEHET NE ORET ME TRAFIK TE PAKESUAR.
- SUBJEKTI KA MARRE MASA PER LAGIEN E HERE PAS HERSHME TE AMBJENTEVE ME QELLIM MOS NGRITJEN E PLUHURAVE
- PER SA I PERKET RUAJTJES DHE MAGAZINIMIT TE LENDEVE TE PARA JANE VENE NE DISPOZICION AMBJENTE TE VEÇUARA DHE TE PERSHTATSHME.

# SUBJEKTI "BAITEL - BOJO RESORT" SH.P.K

- ESHTE KRYER PAJISJA E SUBJEKTIT ME SINJALISTIKEN E DUHUR ME QELLIM SHMANGIEN E AKSIDENTEVE NJERZORE.
- JANE ZBATUAR TE GJITHA NORMAT LIGJORE PER SHKARKIMET NE TOKE, UJE DHE AJER.
- JANE MARRE MASA PER PARANDALIMIN E RENIEVE TE ZJARRIT DHE JANE SIGURUAR MJETET E NDERHYRJES NE RAST TE RENIES SE ZJARRIT
- KY AKTIVITET I KUSHTON RENDESI TE VECANTE MBROJTJES SE MJEDISIT DHE NE RAST NDOTJE BRENDA APO JASHTE OBJEKTIT DO TE MERREN MASA QE TE PASTROHEN MENJEHERE.
- PARKIMI I MJETEVE DHE RUAJTJA E MAKINERIVE BEHET BRENDA SIPERFAQES SE OBJEKTIT.
- TRANSPORTI I MATERIALEVE ESHTE BERE ME MJETE TË PASTRA NGA BALTA DHE TË MBULUARA. ESHTE MENJANUAR RËNIA E BORIVE TË AUTOMJETEVE NGA SHOFERËT PËR TË MOS KRIJUAR ZHURMË DHE STRES TEK BANORËT.
- MANIKERITË JANE MIRËMBAJTUR TEKNIKISHT. ATO JANE PËRDORUR ME EFIÇENCË DUKE MINIMIZUAR KOHEN GJATË SË CILËS MBAHEN NDEZUR MOTORËT.
- SHERBIMI I AUTOMJETEVE, MAGAZINIMI OSE MBAJTJA E MJETEVE NDIHMESE BEHET NE AMBIENTE TE VECANTA TE TILLA QE EVITOJNE NDOTJEN E MJEDISIT NGA KY PROCES.
- SUBJEKTI KA ZBATUAR KERKESAT E LEJES MJEDISORE SI DHE NORMAT E STANDARDET QE KANE TE BEJNE ME MBROJTJEN E MJEDISIT DHE SHENDETIT NGA NDIKIMET NEGATIVE TE VEPRIMTARISE.
- PASTROHEN MENJEHERE RRJEDHJET, DERDHJET, PIKIMET QE MUND TE SHKAKTOJNE AUTOMJETET GJATE TRANSPORTIT ,PER TE PARANDALUAR NDOTJEN E TOKES.
- RESPEKTOHEN STANDARDET E NORMATIVAT PER NIVELIN E ZHURMAVE TE LEJUAR SIPAS STANDARTIT TE BE-SE.

# SUBJEKTI “BAITEL - BOJO RESORT” SH.P.K

**KONKLUZIONE**

NË MATERIALIN E MËSIPËRM SHIHET SE KA NJË NDIKIM MINIMAL, POR GJITHSESI SUBJEKTI “BAITEL - BOJO RESORT” ËSHTË I NDËRGJEGJSHEM SE SADO MINIMAL KY NDIKIM DUHET TË MIRË-MENAXHOHET DHE TË BËHEN PERPJEKJE TEKNIKE PËR TË BËRË KËTË NDIKIM ME VLERE ZERO.

AKTIVITETI KONSIDEROHET I PËRSHTATSHËM DHE I PRANUESHËM NË ZONËN E ZGJEDHUR NGA INVESTITORI, PA KRIJUAR PROBLEME MJEDISORE PËR ZONËN PËRRETH. SUBJEKTI “BAITEL - BOJO RESORT” DO TA USHTROJË VEPRIMTARINË NË PËRPUTHJE ME LEGJISLACIONIN SHQIPTAR NË FUSHËN E MBROJTJES SË MJEDISIT DHE DO TË INVESTOJË PËR PËRMIRËSIMIN E MJEDISIT, PUNËS DHE DO TË MIRËPRESI CDO SYGJERIM NË TË MIRË TË CILËSISË SË PUNËS, SI DHE AKTIVITETI KA BËRË TË MUNDUR ZBUTJEN E PAPUNËSISË NË KËTË ZONË, DUKE PUNËSUAR NJË PJESË TË MIRË TË BANORËVE TË KËSAJ ZONE.

AKTIVITETI JONE NE PERPUTHJE ME VKM NR. 419 DATE 25.06.2014 PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE TË POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPAVE A, B DHE C, PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE NGA NJË SUBJEKT TE TJETRI, TË KUSHTEVE PËR LEJET RESPEKTIVE TË MJEDISIT, SI DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR SHQYRTIMIN E TYRE NGA AUTORITETET KOMPETENTE DERI NË LËSHIMIN E KËTYRE LEJEVE NGA QKB-JA , KY SUBJEKT DUHET TE APLIKOJE PER LEJE MJEDISI TË TIPIT B NE AKM-TIRANE.

ADRESA E AKM-SE, KU PUBLIKU MUND TE DERGOJE KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NE FORME ELEKTRONIKE:

ADRESA: RRUGA “SAMI FRASHERI” NR.4, TIRANE, - TEL/FAX 04 2 371 237 WWW.AKM.GOV.AL

KONFORM TE TE GJITHA AKTEVE DHE PROCEDURAVE LIGJORE NE FUQI I DREJTOHEM AKM- TIRANE PER NDJEKJEN E PROCEDURES KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE PALET E INTERESUARA PER APLIKIMIN PER LEJE MJEDISI TË TIPIT B:

**“TRAJTIMI I UJËRAVE DHE UJËRAVE TË ZEZA”**
**ID 6.1. INSTALIM TRAJTIMI PËR UJËRAT E NDOTURA URBANE - KAPACITETI KUFI PER**

# SUBJEKTI "BAITEL - BOJO RESORT" SH.P.K

**LEJET E TIPIT B: TË GJITHA INSTALIMET.**

TE MERREN MASA PER TE ELEMINUAR NDONJE NDOTJE AKSIDENTALE GJATE PUNES NE RAST SE ATO SHFAQEN NGA PAKUJDESI NJEREZORE.

TE NJIHEN PUNONJESIT PERIODIKISHT ME RREGULLAT E SIGURIMIT TEKNIK DHE RREGULLAT HIGJENO SANITARE QE DUHEN ZBATUAR GJATE PROCESIT TE PUNES.

TE LARGOHEN TE GJITHA MBETJET E NGURTA QE KRIJOHEN SI REZULTAT I PUNES DHE AKTIVITETIT (NESE KA).

PER SA ME SIPER SUBJEKTI "BAITEL - BOJO RESORT" E USHTRON VEPRIMTARINE NE PERPUTHJE ME LEGJISLACIONIN SHQIPTAR NE FUSHEN E MBROJTJES SE MJEDISIT, KA INVESTUAR PER PERMIRESIMIN E MJEDISIT DHE MIREPRET ÇDO SYGJERIM NE TE MIRE TE CILESISE SE PUNES

**KERKUESI**

**DRITAN ARAPI**

STUDIO EKO-KËSHILLIM SEK TIRANA - ALBANIA

*TEL: 0698591968*

*EMAIL: sek.lejemjedisore@yahoo.com*